



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1359 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

**VENDIM Nr. 211, datë 31.10.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", segmenti "Selenicë – Kuç – Qeparo"** -subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA).

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", segmenti "Selenicë – Kuç – Qeparo"** -subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA).
2. Të spostohet gjurma e rrugës në gjatësinë e përfshirë ndërmjet PG.2+071.00 - PG.2+222.00, duke ju larguar Kodrës pranë fshatit Gjorm, ku janë evidentuar gjetje arkeologjike, me qëllim mosdëmtimin dhe ruajtjen e këtyre gjetjeve.
3. Subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projektit "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", segmenti "Selenicë – Kuç – Qeparo", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë  
Tel: ++355 04 45 35 855  
email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)  
Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)